

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a me seli ne Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuara Bedrie Mjeku, kundër të paditurit NTP “D.” me numer te biznesit *numër i biznesit...*, me seli në P. të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor O. T., për shkak të borxhit, vlera e kontestit 828.31 €, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 15.10.2015, me datën 20.10.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. SHFUQIZOHET aktvendimi i kësaj gjykate, për caktimin e përmbarimit, E.nr.1195/13, i dt.18.10.2013, dhe abrogohen veprimet e ndërmarra në procedurë përmbarimore

II. Miratohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompanija Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” me seli ne Prishtinë, ashtu që detyrohet i padituri NTP “D.” me seli në P., që t’ia paguajë paditësit borxhin në shumën prej 440.12 €, ne emër te shërbimeve te ofruara për heqjen e mbeturinave, me kamatë ligjore, prej 3.5 % në vit, duke e llogaritur nga data e parashtrimit te padisë në gjykatë, përkatësisht data 10.10.2013, e deri ne pagesën definitive, si dhe t’ia paguaj shpenzimet procedurale, në shumën prej 30 €, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

III. Refuzohet pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, edhe atë, përkitazi me shumën e kërkuar te borxhit prej 562.33 €, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

A r s y e t i m i

Paditësi Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, me seli ne Prishtinë, me datën 10.10.2013, ka paraqitur padi kundër të paditurit NTP “D.” me seli ne P., me të cilin i ka propozuar gjykatës që të detyrohet i paditurit të ja paguaj borxhin në shumën prej 828.31 €, me kamatë sipas normës vjetore për mjetet e deponuara në bankat komerciale, pa destinim të caktuar në afat prej një viti, duke filluar nga data e paraqitjes se padisë ne gjykatë e deri ne pagimin definitiv. Me parashtrësën e dt.14.09.2015 e ka precizuar kërkesë-padinë në lartësinë prej 1.002.88 €, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare a qëndruar pranë padisë dhe kërkesës se saj, dhe i ka propozuar gjykatës qe të njëjtën ta miratoj në tërësi si te bazuar.

I padituri me kundërshtimin e tij të dt.29.09.2015, gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe në fjalën e tij përfundimtare është thirrur në parashkrim, dhe e ka kundërshtuar pagesën e borxhit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës, si në vijim: kartela-ekstrakti i ndërrimeve të subjektit afarist për vitet 2004-2013, kartela e klientit për të paditurën për përudhën 01.01.1015-31.12.2015, dhe të dhënat për biznesin NTP “D.” me nr te biznesit *numër i biznesit...*, nga faqja zyrtare e RRBK-së.

Duke vlerësuar me ndërgjegje secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: paditësi dhe i padituri kanë pasur raporte te përhershme afariste, nga te cilat kanë marrur te drejta dhe detyrime reciproke, ku paditësi ka marrë

detyrim ofrimin e shërbimeve-heqjen e mbeturinave, ndërsa i padituri pagesën për shërbimet e kryera nga paditesi.

Nga kartelat e prezantuara nga paditesi u vërtetua se paditësi i ka kryer shërbimet e kontraktuara, si dhe i ka faturuar dhe regjistruar obligimet e të paditurit, por i padituri nuk i ka përmbushë detyrimet e tij. Borxhi i tërësishëm i të paditurit ka arritur shumën prej 1,002.45 €. Në kartelat e klientit është evidentuar gabimisht emri “D.1”, por paditësi me ka argumentuar se në fakt kartelat i janë referuar të paditurit “D.”, me të cilin qëndrim është pajtuar në tërësi i padituri. Megjithë gabimin teknik në emër, kartelat përmbajnë saktë numrin e biznesit të të paditurit, *numër i biznesit...*, i cili nr. i përket të paditurit “D.”.

Me dispozitat e nenit 17.1. të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Ndërsa në dispozitat e nenit 262 par.1. të LMD-së, është përcaktuar se kreditori në raportin detyrimorë është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë detyrimin në mënyrë të ndërgjegjshme.

Gjykata e ka shqyrtuar prapësimin e parashkrimit të paraqitur nga i padituri dhe ka ardhur në përfundimin se një pjesë e borxhit është parashkruar.

Me nenin 374 të LMD-së është përcaktuar se “kërkesat reciproke të personave juridik nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri vite”.

Borxhi është faturuar në vitet 2004 - 2015. Procedura gjyqësore për kompensimin e borxhit është iniciuar me dt.10.10.2013. Nga kjo rrjedh se të gjitha borxhet e krijuara para datës 10.10.2010, janë parashkruar. Nga kartelat e debitorit gjykata ka konstatuar se borxhi i parashkruar është në shumën prej 562.33 € (borxh i viteve 2004- tetor 2010), ndërsa borxhi i cili nuk është parashkruar është në shumën prej 440.12 € (borxh i periudhës nëntor 2010 – gusht 2015).

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata pjesërisht e miratoi kërkesëpadinë e pjesërisht e refuzoi atë.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është i bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së. Pala paditëse ka kërkuar pagimin e shpenzimeve procedurale, edhe atë, në shumën prej 30.00 € në emër të taksës për padi dhe aktgjykim, e cila kërkesë është miratuar nga gjykata me këtë aktgjykim.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
I.C.nr.644/2013, me datën 20.10.2015

Gjyqtari,
Bajram Miftari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.